



Honorarkonsulat der Republik Albanien

Rellinghauser Str. 22 | 45128 Essen

PER TE GJITHE QYTETARET SHQIPTARE

Essen, më 7 mars 2017

SHERBIME KONSULLORE – NJOFTIM I MINISTRISË SE PUNEVE TE JASHTME

Të nderuar përfaqësues të Diasporës,

Në kuadër të njoftimit tonë të mëparshëm për lançimin nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Platformës së Shërbimeve Konsullore Online (SHKO) (<https://e-albania.al>) , dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se të gjitha shërbimet konsullore që deri më tani ofroheshin në përfaqësitë konsullore/diplomatike, duke filluar **nga data 1 maj 2017**, do të jenë të disponueshme **vetëm online** nëpërmjet kësaj platforme.

Shërbimet të cilat nga data 1 maj 2017 do të ofrohen **vetëm** përmes Platformës SHKO <https://e-albania.al> janë si më poshtë:



23 nga këto shërbime do të kryhen tërësisht online (https://e-albania.al) dhe dokumenti i kërkuar do t'i dërgohet qytetarit me postë në adresën e shënuar	13 shërbimet do të kryhen online (https://e-albania.al) dhe qytetari do të paraqitet vetëm një herë në zyrat e Ambasades se Republikës së Shqipërisë në BERLIN (drejtoria konsullore) për të firmosur në prezencë të konsullit të Republikës së Shqipërisë në BERLIN
Aplikim për Asistencë të Përgjithshme	Aplikim për Shtetësi Shqiptare me Dhënie
Aplikim për Asistencë për shtetasit shqiptarë të humbur	Aplikim për Shtetësi Shqiptare me Njohje
Aplikim për Asistencë për shtetasit shqiptarë të ndaluar ose të burgosur	Aplikim për Rifitim Shtetësie Shqiptare
Aplikim për Leje Transporti Trupi	Aplikim për Lënie Shtetësie Shqiptare
Aplikim për Regjistrim Fëmije	Aplikim për Lidhje Martese me Shtetas Shqiptar
Aplikim për Çertifikatë Lindje (e vlefshme vetëm për Italinë)	Aplikim për Lidhje Martese me Shtetas të Huaj
Aplikim për Regjistrim Martese	Aplikim për Prokurë të Posaçme
Aplikim për Çertifikatë Martese (e vlefshme vetëm për Italinë)	Aplikim për Deklaratë Noteriale
Aplikim për Regjistrim Vdekje	Aplikim për Autentifikim Nënshkrimi
Aplikim për Çertifikatë Vdekje (e vlefshme vetëm për Italinë)	Aplikim për Procesverbal
Aplikim për Leje Martese (e vlefshme vetëm për Italinë)	
Aplikim për Ekstrakt Dokumenti (Dublikatë)	
Aplikim për Njehsimin e Kopjes me Originalin	
Aplikim për Vërtetim Konsullor mbi të Dhënat Personale	
Aplikim për Vërtetim Konsullor mbi të Dhënat e	



Sakta	
Aplikim për Vërtetim Çertifikatë Lindje	
Aplikim për Vërtetim Çertifikatë Martese	
Aplikim për Vërtetim Çertifikatë Familjare	
Aplikim për Vërtetime të tjera Konsullore	
Aplikim për Përkthim	
Aplikim për Legalizimin e Dokumenteve të lëshuara nga institucione të huaja	
Aplikim për Leje Kalimi	

Duke ju falënderuar, lutemi shpërndarjen në mënyrë sa më të gjerë të këtij informacioni shtetasve shqiptarë duke përdorur mekanizmat tuaja të informimit, bisedat me miqtë, email-it, mediave dixhitale, vizuale apo të shkruar në vendet respektive, të cilat aksesohen nga shtetasit shqiptarë, me qëllim informimin e tyre dhe aksesimin e këtij shërbimi.

Për çdo paqartësi ose pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e platformës SHKO, jeni të lutur t'i adresoheni nëpërmjet kontakteve (email, telefon, mediave sociale)

VETEM: AMBASADES SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE BERLIN
(<http://www.ambasadat.gov.al/germany>) ose të komunikoni me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Diplomacisë Publike, Partneriteteve dhe Diasporës
Spektori i Diasporës